

VENDIM
Nr.212, datë 30.1.2004

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADIO VENDOR PRIVAT “NACIONAL A.H.”
SUBJEKTIT: “RADIO NACIONAL A.H.” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, vendimin nr.204, datë 26.12.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin nëntor, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqëria “Radio Nacional A.H.” sh.p.k. me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonik, tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela